

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-012/14

**Prishtinë,
21 October 2015**

Në çështjen juridike të:

P.R

Shpenadi
Prizren

Pala ankuese

kundër.

T.K

KC Vranjska Banja “Rasadnici”
17542 Vranjska Banja
Serbi

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/100/2011 (lënda e regjistruar si KPA16057) të datës 23 shkurt 2011, pas seancës gjyqësore të mbajtur më 21 tetor 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e P.R. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/100/2011 (lënda e regjistruar si KPA16057) të datës 23 shkurt 2011.

Konfirmohet vendimi i sipërpërmendur i KKPK-ës.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 13 shtator 2006 T.S.K (në tekstin e mëtejme: “paraqitësi i kërkesës”) si anëtar i familjes së ngushtë të babait të tij S.K, ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkon vërtetimin e pronësisë dhe ri-posedim mbi ngastrën 155 prej 41 ari dhe 62 metra katrorë, në rrugën “Gornja Kamenica” (në tekstin e mëtejme: “prona e kërkuar”), Fleta Poseduese nr. 11, Zona Kadastrale Shpenadi, Prizren.

Prona pretendohet të ketë humbur për shkak të rrethanave që kanë ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998/1999.

2. Paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar në mes tjerash në AKP:
 - Transkriptin/ekstraktin nga Fleta Poseduese (FP) nr. 11, të lëshuar më 4 korrik 2003 nga Qendra për Kadaster të Pronës së Paluajtshme e Komunës së Prishtinës, në të cilën S.K paraqitet si bartës i së drejtës pronësore të pronës së kërkuar.
 - Kopjen e planit (KP) nr. 953-2/2003-218, të lëshuar nga Zyra për Pronë të Paluajtshme e Komunës së Prizrenit më 4 korrik 2003;
 - Certifikatën e vdekjes nr. 2/1986, të lëshuar nga Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) më 6 dhjetor 2007, e cila vërteton vdekjen e S.K
 - Letërnjoftimin e paraqitësit të kërkesës nr. 170902, të lëshuar nga Republika e Serbisë më 17 maj 1993.
3. Raportet e verifikimit (të datave 14 mars 2007 dhe 13 shkurt 2008) tregojnë se FP dhe KP ishin verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive (SE) në AKP. SE *ex officio* ka vërtetuar

- se në planin aktual kadastral prona ka të njëjtin numër dhe sipërfaqe – ngastra 155 prej 41 ari dhe 62 metra katrorë dhe është e regjistruar në emër të bartësi të së drejtës pronësore.
4. Kërkesa është konsideruar si e pakontestuar.
 5. Më 19 shkurt 2010, KKPK me Rezolutën e saj KPCC/RES/15/2010 shfuqizon Vendimin e KKPK-së, KPCC/A/13/2008 të datës 30 prill 2008 dhe dërgon kërkesën në Sekretarinë Ekzekutive të AKP-së dhe në Komision për trajtim të mëtejme dhe për vendim bazuar në identifikimin e saktë dhe njoftimin e duhur të pronës së kërkuar.
 6. Me 24 shtator 2010, Sekretariati Ekzekutiv i AKP-ës ka bërë rinjoftimin e pronës së kërkuar përmes publikimit në gazetën e saj nr. 9 dhe Buletinin e zyrës së pronës së UNHCHR. Ekipi i Njoftimit i AKP-ës kishte lënë Gazetën dhe Listen të nipi i kryetarit të fshatit i cili ka siguruar se do të ia dorëzonte atë kryetarit të fshatit, i cili kishte pranuar se do ta bente çashëm për palët e interesuara. Publikimi ishte vendosur në dy ngastra të ndryshme të fshatit Shpenadi, publikuar në të gjitha Komunat dhe Gjykatat Komunale në regjionin dhe Zyrat Kadastrale të Prizrenit dhe ishte shperndarë në UNHCHR, EULEX, OMBUSPERSON dhe ZCN.
 7. Ankuesi nuk ka marrë pjesë në procedurë.
 8. Më 23 shkurt 2011, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) mori vendimin KPCC/D/A/100/2011 ku miraton kërkesën e paraqitësit të kërkesës si të bazuar. KKPK ka konstatuar se babai i paraqitësit të kërkesës – bartësi i së drejtës pronësore (BDP), është pronar i pronës.
 9. Vendimi i ishte dorëzuar J.K – vajzës së paraqitësit të kërkesës më 13 korrik 2011 ndërsa i njëjti i është dorëzuar P.R (në tekstin e mëtejme: “pala ankuese”) më 24 shtator 2013.
 10. Pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së (në tekstin e mëtejme: “Vendimi i kundërshtuar i KKPK-së”) më 24 tetor 2013.
 11. Z.K – gruaja e paraqitësit të kërkesës (në tekstin e mëtejme: “pala përgjegjëse në ankesë”) kishte dërguar përgjigje në ankesë më 28 janar 2014.

Pretendimet e palëve:*Pala ankuese:*

12. Pala ankuese thekson se vendimi i kundërshtuar i KKPK-së përmban gabime thelbësore ose zbatim të gabuar të së drejtës materiale ose procedurale dhe mbështetet mbi vlerësimin e gabuar apo faktet jo të plota. Për më tepër, pala ankuese pretendon se dispozitivi i vendimit të kundërshtuar të KKPK-së është në kundërshtim me arsyetimin e vet.
13. Pala ankuese thekson se pronar i pronës së kërkuar gjithmonë ka qenë familja e tij dhe se ai disa herë ka provuar të marr dokumentat lidhur me pronësinë mbi pronën e kërkuar por nuk ka mundur pasi që Shërbimi Kadastral ishte përgjigjur se ata nuk kanë asnjë dokument lidhur me të. Prandaj, ai shton se KKPK ka vendosur gabimisht kur ka konstatuar se prona e kërkuar i takon palës përgjegjëse në ankesë dhe jo atij personalisht dhe familjes së tij.

Paraqitësi i kërkesës:

14. Paraqitësi i kërkesës ka theksuar se ai së bashku me vëllain e tij D.K dhe motrën e tij O.K kishin trashëguar pronën e kërkuar pas vdekjes së babait të tij. Ai ka shtuar se vendimi mbi trashëgiminë është duke u proceduar.

Pala përgjegjëse në ankesë:

15. Pala përgjegjëse në ankesë thekson se ankesa e palës ankuese është jashtëligjshme. Ai shtoi se pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën pranë AKP-së dhe si i tillë ai nuk ishte palë në procedurën para AKP/KKPK-së. Prandaj, ai nuk ka të drejtë të paraqes ankesë kundër vendimit të KKPK-së.
16. Pala përgjegjëse në ankesë thekson se pronari i ligjshëm i pronës së kërkuar është babai i ndjerë (S.K - BDP) i bashkëshortit të saj (T.K – paraqitësi i kërkesës) i cili ka paraqitur kërkesë në AKP dhe i cili në ndërkohë edhe ai kishte vdekur me datën 27 shtator 2008, prandaj, ajo kishte zënë vendin e tij në procedurën e mëtejme. Pala përgjegjëse në ankesë sqaron se bazuar në provat e dorëzuara është vërtetuar në mënyrë të qartë se prona e kërkuar ka qenë në posedim të familjes së saj deri në vitin 1999 kur ata ishin detyruar ta lëshonin Kosovën dhe se pala ankuese asnjëherë nuk kishte fituar ndonjë të drejtë mbi të. Ajo ka shtuar se pala ankuese ka nën pronësi një ngastër të së njëjtës madhësi që ndodhet pak më tutje nga prona e kërkuar dhe se pala ankuese dëshiron të zgjas uzurpimin ilegal të pronës së kërkuar. Deklarata e palës ankuese se prona e kërkuar është e regjistruar në emrin e tij nuk

është e vërtetë dhe se kjo është e qartë edhe nga ankesa e tij dhe nga fakti që ai nuk ka dorëzuar asnjë provë për të mbështetur atë.

17. Pala përgjegjëse në ankesë në përgjigjen e saj ndaj ankesës në fund i ka propozuar Gjykatës Supreme që ankesa e palës ankuese të hedhet poshtë si e papranueshme ose të refuzohet si e pabazuar.

18. Pala ankuese nuk ka paraqitur asnjë dokument që mbështet pretendimin e tij në ankesë.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

19. Ankesa është e lejuar.

20. Neni 10.2 i Ligjit 03/L-079 parasheh që çdo person përveç paraqitësit të kërkesës i cili pretendon të ketë të drejtë në pronën e kontestuar bëhet palë në procedurë nëse personi i tillë ka informuar Sekretarinë Ekzekutive mbi qëllimin e tij/saj për të marrë pjesë në procedurë brenda afatit 30 ditësh nga data e njoftimit të tij/saj mbi kërkesën.

21. Në rastin në fjalë është e qartë se pala ankuese nuk kishte mundësinë të merrte pjesë në procedurën pranë KKPK-së. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte bërë njoftimin e pronës së kërkuar përmes publikimit në gazetën e saj njoftuese nr. 9 dhe Buletinin e Zyrës së Pronës së UNHCHR-it. Ekipi për Kryerjen e Njoftimit i AKP-së kishte lënë Gazetën dhe Listën te nipi i kryetarit të fshatit që ai ma vonë t'ia dorëzonte atë kryetarit të fshatit, i cili pranoi që ta vinte atë në dispozicion për palët e interesuara. Ky publikim ishte vendosur gjithashtu në dy vende të ndryshme të fshatit Shpenadi. I njëjti është publikuar në të gjitha Komunat dhe Gjykatat Komunale në Rajon dhe gjithashtu në Zyrën Kadastrale në Prizren. Në fund, Gazeta dhe Lista janë shpërndarë në UNHCHR, EULEX, OMBUDSPERSON dhe ICO.

22. Gjykata Supreme konsideron se Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të bërë njoftimin e kërkesës së dorëzuar lidhur me pronën e kërkuar për shkak të mungesës se njoftimit fizik në pronën e kërkuar.

Meritat:

23. Ankesa është e pabazë për shkak se ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi në lidhje me pretendimet e tija. Për më tepër, ai pretendon se kësi lloj dëshmie nuk ekzistonë. Në anën tjetër paraqitësi i kërkesës i ka paraqitur AKP-ës, dhe AKP-ja ka gjetur sipas detyrës zyrtare dëshmi të mjaftueshme që të shpiejnë në perfundimin se kërkesa e paraqitur është e thëmbeltë dhe se duhet të pranohet. Në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi të cilat të mund të rrëzonin ose të paktën të dobësonin këtë përfundim.
24. Nga ajo që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 12.2 të ligjit 03/079 në lidhje me nenin 196 dhe nenin 186.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Gjykata vendosi si në dispozitiv.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it